



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME GJIROKASTER SH.A

MIRATOHET
GENTIAN LLOGO
ADMINISTRATOR



DETYRE PROJEKTIMI
PER HARTIMIN E PROJEKTIT

OBJEKTI: “Studim projektim i furnizimit me ujë për Bashkine Memaliaj”

VENDNDODHJA: Qarku Gjirokastra, Bashkia Memaliaj,
Fshatrat: Arrez e Madhe; Maricaj; Vagalat; Tos Martalloz; Dervishaj;
Bylysh dhe Cerrile.

QELLIMI: Furnizimi me uje te pijshem i fshatrave te Bashkise Memaliaj.

1. HYRJE

Bashkia Memaliaj ndodhet në Qarkun e Gjirokastrës. Ka një sipërfaqe prej 387.65 km², e cila dominohet nga territoret e planifikuara në Sistemin Natyror.


Bashkia Memaliaj përbëhet nga 53 fshatra. Memaliaj është një qytet që rrethohet nga tre anë nga lumi Vjosë, duke i dhënë trajtën e një gadishulli. Klima është e ftohtë dhe e lagësht, ku ndikim të madh ka era e jugut, e cila fryn gjatë gjithë dimrit duke ulur temperaturat.



Fshatrat janë të shpërndarë në të gjithë territorin e bashkisë, duke pasur si qendër organizimi qytetin Memaliaj. Disa fshatra shtrihen buzë lumit Vjosë dhe përreth tij, kurse pjesa tjetër e fshatrave janë të vendosur thellë në territorin malor të Bashkisë. Banesat e fshatrave karakterizohen nga një stil i njëjtë ndërtimi, gati uniform: shtëpi një ose dy katëshe, me veranda dhe fasada kryesisht të bardha. Zona ku mendohet për projektin e furnizimit me ujë ndodhet në lindje të qytetit Memaliaj, përtej lumit Vjosë.

2. KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Aktualisht një pjesë e fshatrave të mësipërm furnizohen me ujë me rrjet totalisht të amortizuar, ndërsa pjesa tjetër nuk ka rrjet ujësjellësi. Vepra e marrjes do të ndërtohet në afërsi të fshatit Arrëz e Madhe.



Fshati Arrëz e Madhe

Kjo zonë ka një rrjet të degraduar dhe shumë të amortizuar, ndërtim i vitit 1980. Banorët e kësaj zone vuajnë prej vitesh mungesën e një rrjeti për furnizimin me ujë 24 orë. Janë bërë ndërhyrje të pjesshme në këtë rrjet, por jo një studim dhe investim i plotë i rrjetit.

Gjendja aktuale është tejte e amortizuar dhe kërkon ndërhyrje emergjente, pasi banorët e këtij fshati janë praktikisht pa ujë. Ajo që është shumë emergjente për ndërhyrje në këtë rrjet është se tubacioni që lidh burimet me njëri-tjetrin është me material eterniti dhe tuba hekuri.

Rrjeti shpërndarës ka pasur disa ndërhyrje fragmentare, por duke qenë se investimi ka qenë i shpërndarë, efektet e tij kanë qenë të pakta ose thuajse asgjë. Rrjeti shpërndarës i këtij fshati është tejte i amortizuar dhe jashtë kontrollit nga lidhjet e paligjshme.

Ka shumë shpërdorime të ujit nga përdoruesit privatë (për ujitjen e kopshteve, përdorim për blegtorinë etj.).

Duke përmbledhur sa më sipër, pjesa më e madhe e banorëve të fshatrave është e interesuar që furnizimi me ujë të pijshëm të bëhet për 24 orë me presion të mjaftueshëm, dhe për këtë ata janë të gatshëm të bashkëpunojnë.

Ky projekt do të zgjidhë përfundimisht problemin e furnizimit me ujë të pijshëm të kësaj zone.

Fshati Maricaj


Kjo zonë ka një rrjet të degraduar dhe shumë të amortizuar, ndërtim rreth vitit 1980. Banorët e kësaj zone vuajnë prej vitesh mungesën e një rrjeti për furnizimin me ujë 24 orë. Janë bërë ndërhyrje të pjesshme në këtë rrjet, por jo një studim dhe investim i plotë i rrjetit.

Gjendja aktuale është tejet e amortizuar dhe kërkon ndërhyrje emergjente, pasi banorët e këtij fshati janë praktikisht pa ujë. Ajo që është shumë emergjente për ndërhyrje në këtë rrjet është se tubacioni që lidh burimet me njëri-tjetrin është me material eterniti dhe tuba hekuri.

Rrjeti shpërndarës ka pasur disa ndërhyrje fragmentare, por duke qenë se investimi ka qenë i shpërndarë, efektet e tij kanë qenë të pakta ose thuajse asgjë. Rrjeti shpërndarës i këtij fshati është tejet i amortizuar dhe jashtë kontrollit nga lidhjet e paligjshme.

Ka shumë shpërdorime të ujit nga përdoruesit privatë. Duke përmbledhur sa më sipër, pjesa më e madhe e banorëve të fshatrave është e interesuar që furnizimi me ujë të pijshëm të bëhet për 24 orë me presion të mjaftueshëm, dhe për këtë ata janë të gatshëm të bashkëpunojnë.

Ky projekt do të zgjidhë përfundimisht problemin e furnizimit me ujë të pijshëm të kësaj zone.



Fshati Tosk Martalloz dhe Dervishaj

Kjo zonë ka një rrjet të degraduar dhe shumë të amortizuar. Banorët e kësaj zone vuajnë prej vitesh mungesën e një rrjeti për furnizimin me ujë 24 orë. Janë bërë ndërhyrje të pjesshme në këtë rrjet, por jo një studim dhe investim i plotë i rrjetit.

Gjendja aktuale është tejet e amortizuar dhe kërkon ndërhyrje emergjente, pasi banorët e këtij fshati janë praktikisht pa ujë. Ajo që është shumë emergjente për ndërhyrje në këtë rrjet është se tubacioni që lidh burimet me njëri-tjetrin është me material eterniti dhe tuba hekuri.

Rrjeti shpërndarës ka pasur disa ndërhyrje fragmentare, por duke qenë se investimi ka qenë i shpërndarë, efektet e tij kanë qenë të pakta ose thuajse asgjë. Rrjeti shpërndarës i këtij fshati është tejet i amortizuar dhe jashtë kontrollit nga lidhjet e paligjshme.

Ka shumë shpërdorime të ujit nga përdoruesit privatë. Duke përmbledhur sa më sipër, pjesa më e madhe e banorëve të fshatrave është e interesuar që furnizimi me ujë të pijshëm të bëhet për 24 orë me presion të mjaftueshëm, dhe për këtë ata janë të gatshëm të bashkëpunojnë.

Ky projekt do të zgjidhë përfundimisht problemin e furnizimit me ujë të pijshëm të kësaj zone.



Fshati Vagalat


Kjo zonë ka një rrjet të degraduar dhe shumë të amortizuar. Banorët e kësaj zone vuajnë prej vitesh mungesën e një rrjeti për furnizimin me ujë 24 orë. Janë bërë ndërhyrje të pjesshme në këtë rrjet, por jo një studim dhe investim i plotë i rrjetit.

Gjendja aktuale është tejet e amortizuar dhe kërkon ndërhyrje emergjente, pasi banorët e këtij fshati janë praktikisht pa ujë. Ajo që është shumë emergjente për ndërhyrje në këtë rrjet është se tubacioni që lidh burimet me njëri-tjetrin është me material eterniti dhe tuba hekuri.

Rrjeti shpërndarës ka pasur disa ndërhyrje fragmentare, por duke qenë se investimi ka qenë i shpërndarë, efektet e tij kanë qenë të pakta ose thuajse asgjë. Rrjeti shpërndarës i këtij fshati është tejet i amortizuar dhe jashtë kontrollit nga lidhjet e paligjshme.

Ka shumë shpërdorime të ujit nga përdoruesit privatë. Duke përmbledhur sa më sipër, pjesa më e madhe e banorëve të fshatrave është e interesuar që furnizimi me ujë të pijshëm të bëhet për 24 orë me presion të mjaftueshëm, dhe për këtë ata janë të gatshëm të bashkëpunojnë.

Ky projekt do të zgjidhë përfundimisht problemin e furnizimit me ujë të pijshëm të kësaj zone.



2.1. Banorët dhe nevojat e tyre për ujë

Pesë fshatrat e përfshira në projekt — Arrëz e Madhe, Maricaj, Vagalat, Tosk Martalloz dhe Dervishaj — i përkasin njësisë administrative Luftinjë të Bashkisë Memaliaj dhe shtrihen në një terren kryesisht kodrinor-malor, në lindje të qytetit Memaliaj, përtej lumit Vjosë. Banorët e këtyre fshatrave jetojnë në një ekonomi familjare të mbështetur kryesisht te bujqësia, blegtoia dhe të ardhurat nga emigracioni; për këtë arsye, furnizimi i qëndrueshëm me ujë të pijshëm ka ndikim të drejtpërdrejtë jo vetëm në cilësinë e jetesës, por edhe në veprimtarinë ekonomike të zonës.

Gjendja aktuale e furnizimit me ujë ndikon negativisht në shëndetin dhe higjienën e familjeve. Mungesa e ujit 24 orë i detyron banorët të grumbullojnë ujë në rezervuarë të improvizuar, gjë që rrit rrezikun e ndotjes dytësore dhe të sëmundjeve me bartje ujore. Kategoritë më të cenueshme — fëmijët, të moshuarit dhe personat me probleme shëndetësore — preken në mënyrë të veçantë nga ndërprerjet e shpeshta dhe nga presioni i ulët.

Popullsia e zonës karakterizohet nga një rënie e theksuar demografike, si pasojë e emigrimit dhe e largimit drejt qendrave urbane. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e banorëve ruan banesat dhe lidhjet me fshatin, duke u kthyer veçanërisht gjatë sezonit veror dhe festave; kjo sjell luhatje sezonale të kërkesës për ujë, të cilat projekti duhet t'i marrë parasysh. Përmirësimi i infrastrukturës së ujësjellësit konsiderohet gjithashtu një kusht i rëndësishëm për të nxitur qëndrimin e familjeve në zonë dhe kthimin e emigrantëve.

Nga konsultimet me komunitetin rezulton se pjesa më e madhe e banorëve është e gatshme të bashkëpunojë me Bashkinë Memaliaj dhe me operatorin e ujësjellësit për realizimin e projektit, duke përfshirë lidhjen e rregullt të kontratave, vendosjen e ujëmatësave individualë dhe pagesën e faturave të konsumit. Ndërgjegjësimi i banorëve për përdorimin racional të ujit dhe eliminimi i lidhjeve të paligjshme janë elemente thelbësore për qëndrueshmërinë financiare dhe teknike të skemës së projektuar.

3. OBJEKTIVI

Objekti i detyrës së projektimit është hartimi i projektit të ujësjellësit për fshatrat Arrëz e Madhe; Maricaj; Vagalat; Tosk Martalloz; Dervishaj

1. Ndërtimin e rrjetit kryesor të furnizimit, së bashku me veprën e marrjes
2. Ndërtimin e depove të secilit fshat
3. Ndërtimin e rrjetit të jashtëm për secilin fshat
4. Të zëvendësohen linjat ekzistuese të amortizuara dhe të realizohen linjat e reja të shpërndarjes, për të siguruar furnizimin me ujë 24 orë të zonës së projektit për një periudhë 25-vjeçare
5. Ndërtimin e pusetave të reduktorëve të presionit dhe të komandimit, dhomës së shërbimit dhe pusetave të ajrimit
6. Instalimi i pusetave individuale ose kolektive të matësave të ujit për çdo abonent
7. Projektuesi duhet të bëjë studimin e projektit në fazën e projektit paraprak të objektit në jo më pak se 2 variante.

Skema e ndërtimit të depove të ujit dhe e veprës së marrjes së ujit:



4. QËLLIMI I PUNËS

Qëllimi i këtij shërbimi është kryerja e Studim-Projektimit të furnizimit me ujë dhe i të gjithë komponentëve përbërës të këtij furnizimi, duke përfshirë burimet, kaptazhet, rezervuarët, linjën e transmetimit, rrjetin e shpërndarjes dhe lidhjet e shtëpive për zonat e përzgjedhura. Hartimi i projektit të objektit: Studim Projektim “Ujësjellësi për fshatrat e Bashkisë Memaliaj: Arrëz e Madhe; Maricaj; Vagalat; Tosk Martaloz; Dervishaj”, sipas VKM-së Nr. 354, datë 11.05.2016.

Projekti përfundimtar i veprës ka si qëllim:

- Furnizimin me ujë 24 orë të fshatrave të mësipërm të Bashkisë Memaliaj, parashikuar kjo për 25 vite
- Furnizimin e klientëve me ujë sipas Legjislacionit Shqiptar dhe kriterëve minimale të mëposhtme: furnizim 24 orë me presion të mjaftueshëm (min. 15 m në dalje në çezmën e konsumatorit) me ujë me cilësi sipas Standardeve Shqiptare dhe udhëzimeve të BE-së
- Sigurimin e një skeme të projektuar për operim me gravitet
- Eliminimin e puseve dhe elektropompave
- Projektimin e rrjetit shpërndarës për të siguruar ujë në lidhjet e konsumatorëve me presion minimal prej 1.5 bar dhe maksimal 6.0 bar

Për realizimin e projektit, projektuesi duhet të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me projektin që duhet të hartojë për furnizimin me ujë sipas detyrës së projektimit, dhe të konsultohet me Bashkinë Memaliaj, Ujësjellësin, KESH, OSSHE dhe çdo palë tjetër interesi.

Cilësia e studimit të projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standardi i kërkuar, që të plotësojë kushtet e projektimit. Vlera financiare e llogaritur, sipas preventivit që do të jetë bashkëlidhur detyrës së projektimit, është e përafërt.

4.1. Rezultatet e pritshme

- Mbulimi i plotë me rrjet i ujësjellësit, për të furnizuar me ujë të gjitha fshatrat ku mungon kjo infrastrukturë, duke plotësuar nevojat për ujë të lokaliteteve.
- Rikonstruksioni dhe zëvendësimi i rrjetit të ujësjellësit në gjendje të amortizuar, përfshirë pusetat e manovrimit, të reduktorëve të presionit, të ajrimit dhe kasetat e matësve individualë.
- Treguesi për matjen e suksesit të programit është lidhja 100% e popullatës që jeton në zonën e furnizimit (rezultati i drejtpërdrejtë) dhe standardet e vazhdueshme (24 orë/ditë — rezultat indirekt/afatgjatë).
- Masat përfshijnë rehabilitimin dhe ndërtimin e sistemeve të furnizimit me ujë.

5. TË DHËNAT E PROJEKTIMIT

- Popullsia aktuale sipas fshatrave.
- Shtesa natyrale e popullsisë të merret 1%.
- Perspektiva e ujësjellësit të parashikohet për 25 vjet.
- Nevojat për ujë për banor (150 l/ditë/banor).
- Koeficienti ditor i përdorimit të ujit: 1.4.
- Humbjet në rrjetin shpërndarës të furnizimit me ujë llogariten 20%.
- Materiali i tubacionit të jetë çelik ose HDPE i çertifikuar (PE/RC).

Të dhënat e popullsisë sipas fshatrave:

Bashkia Memaliaj	Popullsia totale që jeton në zonën e juridiksionit (sipas ndarjes territoriale)	Orari i furnizimit me ujë (orë/ditë)	Numri total i abonentëve (me dhe pa matës)	Numri i abonentëve me ujëmatës
Arrëz e Madhe	1100		200	
Maricaj	785		200	
Vagalat	650		200	
Tosk Martalloz	284		200	
Dervishaj	350		200	

5.1. Saktësim mbi numrin e banorëve

Të dhënat e popullsisë të paraqitura në tabelën e mësipërme (gjithsej rreth 3 169 banorë për pesë fshatrat) duhet të lexohen si popullsi e regjistruar / e projektuar për qëllime dimensionimi, dhe jo si popullsi rezidente e numëruar nga censusi. Ky saktësim është i rëndësishëm, sepse të dhënat zyrtare të censusit japin një tablo dukshëm më të ulët të popullsisë faktike që banon në zonë:

- Sipas Censusit të vitit 2011, e gjithë Bashkia Memaliaj kishte rreth 10 657 banorë rezidentë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil numri arrin në rreth 21 476 banorë.
- E gjithë njësia administrative — që përfshin 15 fshatra, ndër ta edhe të pesë fshatrat e këtij projekti — numëronte vetëm rreth 1 734 banorë rezidentë në Censusin e vitit 2011.

- Ndërmjet viteve 2011 dhe 2023, popullsia rurale e njësisë Luftinjë ka pësuar një rënie prej rreth 45%, një nga rëniet më të larta në qarkun e Gjirokastrës.

Diferenca e madhe ndërmjet popullsisë rezidente (census) dhe popullsisë së regjistruar (Regjistër Civil) shpjegohet me emigrimin e gjerë: shumë banorë e ruajnë regjistrimin dhe banesat në fshat, ndërkohë që jetojnë jashtë vendit ose në qytete, duke u kthyer kryesisht në mënyrë sezonale.

Për qëllime projektimi rekomandohet që:

- Të përcaktohet qartë baza e popullsisë së përdorur (Regjistër Civil, census, ose popullsi e projektuar) dhe burimi përkatës i të dhënave.
- Dimensionimi i veprave të bazohet në popullsinë e regjistruar / të projektuar (skenari maksimal), për të akomoduar kthimin e emigrantëve dhe kulmin sezonal të verës, ndërsa skenari minimal (popullsia rezidente) të përdoret për të verifikuar funksionimin hidraulik në kushte kërkesë të ulët (shpejtësi minimale, mbajtja e ujit në depo, cilësia).
- Numri i banorëve për secilin fshat të verifikohet me të dhënat më të fundit të Censurit 2023 (INSTAT) dhe me regjistrat e Bashkisë Memaliaj para fazës së projekt-idesë përfundimtare.

6. LLOGARITJA PARAPRAKE E NEVOJAVE PËR UJË

Ky seksion paraqet llogaritjen paraprake të nevojave për ujë të popullsisë së zonës që do të furnizohet nga skema e re e ujësjellësit për fshatrat e Bashkisë Memaliaj: Arrëz e Madhe, Maricaj, Vagalat, Tosk Martalloz, Dervishaj, Bylysh dhe Cërrilë.

Llogaritjet janë kryer në bazë të të dhënave të popullsisë sipas regjistrat aktual dhe parametrave të përcaktuar në Detyrën e Projektimit, duke përfshirë rritjen natyrore të popullsisë për një horizont 25-vjeçar dhe duke marrë në konsideratë humbjet në rrjetin shpërndarës.

Rezultatet e këtyre llogaritjeve shërbejnë si bazë për dimensionimin e veprës së marrjes, tubacionit kryesor të transmetimit, depove dhe rrjetit shpërndarës.

6.1. Parametrat e projektimit

Parametri	Simboli	Vlera
Norma e konsumit për banor	q	150 l/ditë/banor
Shtesa natyrore vjetore e popullsisë	r	1.0 %
Perspektiva (horizonti i projektimit)	n	25 vjet
Koeficienti i pabarazisë ditore	Kd	1.4
Koeficienti i pabarazisë orare	Kh	2.0
Humbjet në rrjet	Wp	20 %
Presioni minimal në dalje	Pmin	1.5 bar (15 m)
Presioni maksimal i lejuar	Pmax	6.0 bar

6.2. Projektioni i popullsisë

Popullsia e ardhshme llogaritet sipas formulës së rritjes me përqindje konstante (metoda gjeometrike):

$$P_n = P_0 \times (1 + r)^n$$

ku: P_0 = popullsia aktuale; $r = 0.01$; $n = 25$ vjet.

Faktori i rritjes për 25 vjet me normë 1%: $(1 + 0.01)^{25} = 1.2824$.

Sipas kësaj, popullsia e ardhshme për secilin fshat paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Fshati	Popullsia aktuale	Faktori	Pop. në vitin 25
1	Arrëz e Madhe	1100	1.2824	1411
2	Maricaj	785	1.2824	1007
3	Vagalat	650	1.2824	834
4	Tosk Martalloz	284	1.2824	364
5	Dervishaj	350	1.2824	449

6.3. Llogaritja e prurjeve

Konsumi mesatar ditor i ujit për një fshat llogaritet duke shumëzuar popullsinë e ardhshme me normën e konsumit për banor:

$$Q_{mes} = P_n \times q / 1000 \quad (m^3/ditë)$$

Për të llogaritur prurjen e maksimumit ditor, konsumi mesatar shumëzohet me koeficientin e pabarazisë ditore:

$$Q_{max.dit} = Q_{mes} \times K_d \quad (K_d = 1.4)$$

Prurja për të cilën dimensionohet rrjeti merr parasysh humbjet që ndodhin gjatë shpërndarjes (kryesisht në lidhjet, valvulat dhe nyjet e tubacioneve):

$$Q_{proj} = Q_{max.dit} \times (1 + W_p) \quad (W_p = 0.20)$$

Rezultatet e këtyre llogaritjeve për secilin fshat janë:

Fshati	P_n (banorë)	Q_{mes} ($m^3/ditë$)	$Q_{max.dit}$ ($m^3/ditë$)	Q_{proj} ($m^3/ditë$)
Arrëz e Madhe	1411	211.65	296.31	355.57
Maricaj	1007	151.05	211.47	253.76
Vagalat	834	125.10	175.14	210.17
Tosk Martalloz	364	54.60	76.44	91.73
Dervishaj	449	67.35	94.29	113.15

7. STANDARDET

Standardet në projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projekti duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje

edhe gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Projektuesi duhet të shqyrtojë vizatimet dhe dokumentet e vëna në dispozicion të tij nga njësia e qeverisjes vendore dhe do të inspektojë vendin e projektit dhe rrethinat e tij.

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me gjendjen ekzistuese të objektit në fjalë
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia Memaliaj
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standardi i kërkuar
- Projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës

8. REALIZIMI I PROJEKTIT

8.1 Fazat e projektimit per kete objekt sipas VKM nr. 354 date 11.05.2016 jane:

- Faza I - Analiza e Detyres se Projektimit/Terma Reference dhe percaktimi baze se projektit
- Faza II- Projekt Idea Paraprake
- Faza III- Projekt Idea Perfundimtare
- Faza V - Projekti i Zbatimit
- Faza VI- Preventivi Perfundimtar

8.2 Detyrat e detajuara sipas fazave

FAZA I- Analiza e detyrës së projektimit/termat e references dhe përcaktimi i bazës së projektit

Shërbime bazë

- a) Sqarimi i shtrimit të detyrës për zonën e planifikimit
- b) Vrojtimi i vendit
- c) Përmbledhja e qëllimeve të planifikimit që influencojnë për detyrën
- d) Përmbledhja e dokumentave të vlefshme për kryerjen e shërbimit
- e) Shpjegimi i të dhënave të planit
- f) Llogaritja e vëllimit të punës dhe punimeve paraprake të nevojshme, p.sh. studime të tabanit të ndërtimit, punime matjeje, mbrojtja etj;
- g) Formulimi i ndihmave për vendimin për zgjedhjen e pjesëmarrëve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim.
- h) Përmbledhja e rezultatave
 - i. Shërbimet e veçanta
 - a) Zgjedhja dhe vrojtimi i objekteve të ngjashme;

b) Llogaritja e ngarkesave të veçanta, që nuk janë përcaktuar në normë;

Rezultatet e pritura të këtij aktiviteti do të jenë mbledhja e të dhënave duke sygjerruar:

- ✓ Propozim mbi matjet e testimit në terren për tubacionin kryesor të transmissioinit
- ✓ Raport mbi testet në terren për tubacionin kryesor të transmissioinit.
- ✓ Raporti mbi dimensionimin e matësve të prurjes së tubacionin kryesor të transmissioinit.
- ✓ Propozimi mbi matjet të testimit në terren për sistemin e shpërndarjes së ujit
- ✓ Raport mbi testet në terren për sistemin e shpërndarjes së ujit
- ✓ Raport për kalibrimin e modelimit hidraulik
- ✓ Raport për llogaritjet e bilancit të ujit, duke dhënë hollësi mbi supozimet, vlerësimin dhe rezultatet.
- ✓ Bazën e të dhënave të Bilancit të Ujit dhe mjetin kompjuterik për llogaritjen e tyre

FAZA II- Projekt-idenë paraprake (përgatitja e projektit dhe planifikimit)

Përpunimi i pjesëve të rëndësishme të një zgjidhje të detyrës së planifikimit

i. Shërbime bazë

- a) Akordimi i qëllimeve të përfytyruara me kushtet anësore, të cilat jepen veçanërisht nga rregullimi i territorit, planifikimi i ndërtimit, Planifikimi i detajuar vendor si dhe nga planifikimit vendore dhe kombëtare;
- b) Studimi i mundësive të zgjidhjes me influencat mbi kompozimin ndërtimor dhe konstruktiv, përshtatshmërinë, rentabilitetin duke respektuar pajtueshmërinë me mjedisin, siguri dhe vlerësimi i hartave zyrtare;
- c) Përpunimi i një koncepti planifikimi, përfshirë studimin e zgjidhjeve të mundshme alternative me kërkesa të njejta me paraqitje vizatimore dhe vlerësim duke përpunuar kontribute të pjesëmarrëse të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim;
- d) Sqarimi dhe shpjegimi i lidhjeve themelore specifike të specialistit, procese dhe kushte;
- e) Bisedime paraprake me autoritete dhe pjesëmarrës të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, për aftësinë për miratim dhe pjesëmarrje në shpenzime;
- f) Bashkëveprim në shpjegimin e konceptit të planifikimit kundrejt qytetarëve dhe organeve politike;
- g) Përpunimi i konceptit të planifikimit sipas vërejtjeve dhe propozimeve;
- h) Përgatitja e dokumentave si ekstrakte nga projektideja paraprake për përdorim për një procedurë të rregullimit të territorit;
- i) Vlerësimi i shpenzimeve (preventivi);
- j) Përmbledhja e të gjitha rezultateve të planifikimit paraprak.

Rezultatet e pritura të këtij aktiviteti do të jenë:

- ✓ Modele hidraulike për analiza të skenarëve të ndryshëm
- ✓ Raporti mbi Programin e Rehabilitimit / Optimizimit i cili detajon modelimin e sistemit, analizën e sistemit dhe përzgjedhjen e alternativave për të gjithë zonën e studimit me rekomandimet për UK që duhet të ndërmarë

- ✓ Hartime të hollësishme të projekteve të përforcimit të rrjetit të zonimit dhe punëve të tjera të nevojshme.
- ✓ Hartime të hollësishme të shërbimeve të lidhura me reduktimin dhe menaxhimin e kërkesës së NRW në përdoruesit fundor.
- ✓ Raporti mbi rezultatet e auditimit të ujit të pafaturuar

FAZA III-Projekt-ideja përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integritetit)

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së projektit/termave të referencës.

i. Shërbime bazë

a) Përpunimi i konceptit të planifikimit (përpunimi hap pas hapi i një zgjidhjeje vizatimore) duke pasur parasysh të gjitha kërkesat specifike të fushës dhe duke përdorur kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, deri në projektidenë e plotë.

b) Raport shpjegues

c) Llogaritje specifike të fushës, përjashtoj llogaritjet e strukturës mbajtëse.

ç) Paraqitje vizatimore e të gjithë projekt-idesë.

d) Plani i financimit, plani i kohëve të ndërtimit dhe i shpenzimeve. Llogaritja dhe argumentimi i shpenzimeve që mund të sigurohen me ndihmë (subvencionim) si dhe përgatitja e kërkesave për financim; bashkëpunim gjatë shpjegimit të projektidesë paraprake ndaj qytetarëve dhe organeve publike; Përpunimi i projektidesë sipas vërejtjeve dhe propozimeve.

dh) Bisedime me autoritete dhe pjesëmarrës të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, për aftësinë për miratim.

e) Llogaritja e shpenzimeve

ë) Kontrolli i shpenzimeve duke krahasuar llogaritjen e shpenzimeve me vlerësimin e shpenzimeve

g) Përmbledhja e të gjitha dokumenteve të projektidesë.

ii. Shërbimet e veçanta

a) Sigurimi i ekstrakteve nga libri themeltar, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe dokumente të tjera zyrtare

b) Vazhdimi i studimeve dobi-shpenzime

ç) Bashkëveprim gjatë marrëveshjeve administrative

Studimet e fizibilitetit social dhe teknik

Rezultatet e pritura të këtij aktiviteti do të jenë:

- ✓ Modeli hidraulik dhe analiza të skenarit të zgjedhur
- ✓ Raporti mbi Programin e Rehabilitimit / Optimizimit i cili detajon modelimin e sistemit, analizën e sistemit alternativën e përzgjedhur për të gjithë zonën e studimit

- ✓ Hartimi i plani menaxhimi për zbatimin e planit të veprimit të optimizuar, i cili detajon përgjegjësitë e palëve të interesit, planin e planifikimit dhe buxhetin, planin e prokurimit dhe të burimeve njerëzore dhe planin e menaxhimit të rrezikut.
- ✓ Raport mbi Planin e Veprimit të Optimizuar. Përgatitja e listës projekteve të detajuara duke i prioritetizuar investimet
- ✓ Bazuar në Planin e Veprimit të Optimizuar të hartojë të gjitha ndërhyrjet dhe komponentët e tij të përfshira në Planin e Veprimit në përputhje me legjislacionin në fuqi
- ✓ Përcaktojë alternativat më të realizueshme për zbatimin e Planit të Veprimit me të veçanta konsideratë për kontraktimin e bazuar në performancë.
- ✓ Bazuar në analizat alternative për zbatimin e Planit të Veprimit, përpunohen dokumentet e tenderit për opsionet

FAZA V- Projektet e zbatimit

Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

i. Shërbimet bazë

a) Përpunimi i rezultateve të fazave të punimeve 3 dhe 4 (përgatitja hap pas hapi e zgjidhjes dhe e paraqitjes së saj) duke pasur parasysh të gjitha kërkesat specifike të fushës dhe duke përdorur kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, deri në zgjidhjen e aftë për zbatim.

b) Paraqitje vizatimore dhe llogaritëse e objektit me të gjitha të dhënat e veçanta të nevojshme për zbatimin, përfshirë vizatime të detajuara në shkallët e kërkuara.

c) Përpunimi i bazave për të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, dhe integrimi i kontributeve të tyre deri në zgjidhjen e aftë për zbatim

ç) Vazhdimi i planifikimit të zbatimit gjatë ndërtimit të objektit

ii. Shërbimet e veçanta

d) Hartimi i grafikut të punimeve dhe i planeve të rrjetit të infrastrukturës

Rezultatet e pritura të këtij aktiviteti do të jenë:

1. Hartimi i projekteve të zbatimit sipas prioriteteve përcaktuara dhe punëve të tjera të nevojshme.
2. Hartime të hollësishme të shërbimeve të lidhura me reduktimin dhe menaxhimin e kërkesës së NRW në përdoruesit fundor.

FAZA VI- Preventivi përfundimtar

Llogaritja e sasive, përgatitja e analizave të çmimeve dhe hartimi i dokumentave të tenderit.

i. Shërbimet bazë:

a) Llogaritja e sasive dhe renditja e pozicioneve të veçanta duke përfshirë kontributin e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim;

b) Hartimi i dokumenteve të dhënies, në mënyrë të veçantë i përshkrimeve të punëve me listën e punëve si dhe të kushteve të veçanta kontraktuale;

c) Akordimi dhe koordinimi i dokumenteve të dhënies me pjesëmarrësit e tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim;

ç) Përcaktimi i fazave kryesore të zbatimit;

d) Çmimet e preventivit të hartohet sipas VKM në fuqi

Shërbimet e rilevimit topografik

Shërbimet e rilevimit topografik bazohen në nenin 63 sipas VKM, Nr 354, dt 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" dhe përfshijnë:

d) Këto shërbime duhen cilësuar si shërbime me kërkesa mbi mesataren për topografinë sipas grupit IV tarifar të nenit 67 të V.K.M Nr 354, dt 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim"

Shërbimet për rilevimin topografik në fazën e projektimit janë përcaktuar sipas nenit 66 ku konsulenti do të përgatisë punën për studimin e nevojshëm topografik brenda zonës së projektit sipas fazave së mëposhtme:

Faza I - Analizës e detyrës së projektimit, termave të referencës, dhe përcaktimi bazës së projektit referuar shërbimit topografik.

i. Shërbimet bazë

- a. Gjetja dhe marrja e informacionit dhe dokumentacionit në vendndodhjen ku është planifikuar objekti
- b. Gjetja e dokumentacionit të rilevimit. Inspektimi në vend
- c. Vendosja e qëllimit të projektit e lidhur relativisht me kërkesat e saktësisë dhe shkallën e vështirësisë

ii. Shërbime të veçanta

Marrja e lejeve me shkrim për të hyrë në truallin për ndërtim, leje transporti në ujë dhe leje për masat e sigurisë ndaj trafikut që kërkon autorizim.

Faza II: Grupimi i pikave të palëvizshme gjeodezike

i. Shërbime bazë

- a. Identifikimi dhe shënimi i pikave për pozicionim dhe rilevim.
- b. Hartimi i përshkrimeve për pikat e palëvizshme dhe shoqëruar me skemat përkatëse.
- c. Kryerja e matjeve për të përcaktuar pikat fikse dhe ato të kontrollit.
- d. Analizimi i matjeve dhe hartimi i rrjetit mbështetës gjeodezik dhe atë të rilevimit.

ii. Shërbime të veçanta

- a. Analiza e rrjetit dhe grafikut të punimeve të rilevimit për rrjete tokësore shumë ekzakte.
- b. Shënimi i piketave për kërkesa të veçanta.

- c. Instalimi i pikave fikse dhe stacionet.

Faza III- Planet e pozicionimit dhe të rilevimit

i. Shërbime bazë

- a. Studimet topografike/morfologjike (tokësore/ajrore) duke përfshirë regjistrimet e pikave kufizuese.
- b. Analiza e matjeve/fotografive ajrore.
- c. Hartimi i planeve që paraqesin situatën e objektit duke përfshirë zonën e mbuluar nga projekti dhe të dhënat kadastrale
- d. Paraqitja e rilevimeve në format të pikëzuar, matrica ose në formë vizash konturuese.
- e. Hartimi i një model terreni të dixhitalizuar
- f. Prezantim grafik i kanaleve, rrjetit elektrik, kabllot dhe strukturat nëntokësore sipas dokumentacionit ekzistues.
- g. Të gjitha matjet të jenë në format dixhitale.

ii. Shërbime të veçanta

- a. Masa të shumta për sigurinë nga trafiku që kërkojnë autorizim (nëse del e nevojshme).
- b. Përfshirja e të dhënave të pronësisë.
- c. Paraqitja e të dhënave në shkallë të ndryshme.
- d. Përgatitja e planeve të pozicionit në lidhje me kërkesat ligjore për procedurat e pranimit zyrtar.

Kërkesat që duhet të plotësojë projekti

1. Koorografinë në shkallë 1:25000
2. Hartimin e rilevimit topografik të zonës ku do të ndërhyhet (koordinata lokale, kuota absolute)
3. Planimetria e linjave kryesore, dergimit dhe rrjeteve shpërndares në shkallë 1:1000
4. Profilat Gjatesore në shkallën H 1:2000; V 1:1000 të shoqëruar me të dhënat hidraulike si $\varnothing$ mm, q =lit/sek, v =m/sek, i =m/m
5. Profila Terthore në shkallë 1:20
6. Planimetri, prerje të kaptazheve në shkallë 1:50; 1:100
7. Planimetri, prerje të pus shpimeve në shkallë 1:50; 1:100
8. Detaje të ndryshme në shkallë 1:50
9. Planimetri, prerje, detaje të ndërtimit të rezervuareve
10. Planimetri, prerje, detaje të pusëtave të komandimit në shkallë 1:50; 1:100
11. Planimetri, prerje, detaje të pusëtave të reduktimit të presionit në shkallë 1:50; 1:100
12. Relacioni teknik për zgjedhjen e dhënës sipas detyrës së projektimit
13. Skema Hidraulike
14. Llogaritjet Hidraulike

15. Llogaritjet Konstruktive
16. Specifikimet Teknike
17. Raport i Vleresimit Mjedisor
18. Raport Hidrologjik
19. Raporti Gjeologjik
20. Studimi Hidrogeologjik i të gjitha resurseve ujore të zonës në studim, sipas VKM Nr. 319, datë 11.06.2025
21. Në studimin Hidrogeologjik të jepen dy apo më shumë variante për furnizimin me ujë të këtyre fshatrave
22. Analiza fiziko-kimike dhe bakteriologjike pranë ISHP për burimet e marra në studim
23. Oponenca Hidrogeologjike e raportit Hidrogeologjik
24. Studimi i zonave sanitare për burimet që do të shfrytëzohen për furnizim me ujë të këtyre fshatrave.
25. Në Relacionin Teknik të jenë të përfshira variantet e furnizimit me ujë sipas variantëve të raportit hidrogeologjik.
26. Preventivi përfundimtar dhe analizat e çmimeve përfundimtare

Grafiku i Realizimit të Produktit

- ✓ Analiza e detyres së projektimit/termat e references dhe përcaktimi i bazës së projektit, **15 dite** (situatë ekzistuese e dokumentuar në raport dhe harta në lidhje me sistemin ekzistues dhe projekteve në vazhdim të furnizimit me ujë)
- ✓ Projekt-idenë paraprake, **15 dite** (Skema hidraulike paraprake, raportet mbi përshkrimin e shkurtër të skemës ekzistuese apo asaj propozuese, kriteret e projektimit, burimet e ujit, rrjeti i transmetimit, rrjeti shpërndarës dhe rezervuarët, vlerësimi i kostos në njësi, kostot e investimit në total dhe kostot e operimit dhe mirëmbajtjes, dokumenta të mbledhura për planifikimin dhe preventivi paraprak)
- ✓ Projekt ideja përfundimtare, **10 dite** (Skema hidraulike përfundimtare, raportet mbi përshkrimin e skemës përfundimtare, kriteret e projektimit, burimet e ujit, rrjeti i transmetimit, rrjeti shpërndarës dhe rezervuarët, problemet me pronësinë, vlerësimi i kostos në njësi, kostot e investimit në total dhe kostot e operimit dhe mirëmbajtjes, grafiku i punimeve dhe dokumentat e mbledhura për planifikimin,
- ✓ Projektet e zbatimit finale, **10 dite** (përfshin të gjitha vizatimet përfundimtare, relacionet teknike, specifikimet, analizën tekniko-ekonomike raportet të përmendura me lart sipas detyrave të përcaktuara në këto terma) + VNM përfundimtare
- ✓ Preventivi përfundimtar dhe analizat e çmimeve përfundimtare, **5 ditë**

Raportimi

I gjithë projekti do të paraqitet në 3 kopje të printuara

- në format A3 Paraqitja grafike e projektit
- në format A4 relacioni teknik, llogaritjet, specifikimet teknike, grafiku i punimeve dhe preventivi me çmime dhe pa çmime

Gjithashtu i gjithë projekti do të dorëzohet në 2 kopje CD në versionin të dixhitalizuar (1 CD me file të punuar dhe 1 CD me gjithë dokumentacionin e kthyer në format PDF).

9. PARTNERET DHE FINANCOESIT E PROJEKTIT

Bashkia Memaliaj

Agjencia Kombëtare Ujesjelles Kanalizime

BAZA LIGJORE E REFERUAR

- VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 – mbi fazat e projektimit dhe llogaritjen e vlerës së shërbimit (Neni 42).
- VKM Nr. 319, datë 11.06.2025 – mbi studimin hidrogeologjik të resurseve ujore.
- VKM Nr. 379, datë 25.05.2016 – mbi cilësinë e ujit të pijshëm.
- Urdhër-Shërbimi Nr. 119 dhe Nr. 120, datë 28.04.2026, dhe procesverbali i verifikimit në terren, datë 25.05.2026 (AKUK – Drejtoria e Planifikimit të Investimeve).
- Manuallet teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre (miratuar 2024).

SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME GJIROKASTER SH.A

Hartoi: Ing.Çelestina Dajlani



Miratoi: Administratori

Gestian Drego

